# DËSHMI ARKIVI

**A-457763**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Goditet rrjeti i kokainës në Laç/ Arrestohen dy të rinj, iu sekuestruan 80 doza gati për shitje |
| ADRESA | `https://piranjat.al/aktualitet/goditet-rrjeti-i-kokaines-ne-lac-arrestohen-dy-te-rinj-iu-sekuestruan-i104997` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 12:57:30 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 12:47:52 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `97249dd04ee8525e7869db1f9b2cfd3d3bdeae38fdcbbb1986e6ee5d4f81a3df` |
| TEKSTI | `1ad84452b0b9f0903aeb00ea8f993127501b392548327407975e23e5bd2467f8` |
| PAMJA | `3c393382ffb58fd135f8fc7a8952a65f9b1722302e59b36faafbf3b485395fb3` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6f694bf6a85df0d0b7753d8b72bd61491887042d3b9ce3182e7f18bcd5d87868` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `aea7d85c4e1ffedb330a4f0c595bceb62319ead8019dd1bf570799cb9f2d4d85` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6f694bf6a85df0d0b7753d8b72bd61491887042d3b9ce3182e7f18bcd5d87868`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# Goditet rrjeti i kokainës në Laç/ Arrestohen dy të rinj, iu sekuestruan 80 doza gati për shitje

Piranjat Përditësimi i fundit 19 Shtator 2026, 14:47




Një tjetër goditje ndaj shpërndarjes së lëndëve narkotike është finalizuar nga Seksioni për Hetimin e Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Kurbin. Në kuadër të operacionit të koduar "Destinacioni", forcat e rendit kanë prangosur dy të rinj të cilët udhëtonin nga qytete të tjera për të shpërndarë doza kokaine në qytetin e Laçit.

Sipas njoftimit zyrtar të policisë, në pranga u vunë shtetasit G. M., 28 vjeç, banues në Lushnjë, dhe S. K., 19 vjeç, banues në Tiranë. Të dy këta persona u lokalizuan dhe u bllokuan nga patrullat në lagjen nr. 6 të qytetit të Laçit, gjatë një kontrolli të ushtruar mbi automjetin me të cilin udhëtonin.

Gjatë kontrollit të detajuar të mjetit, efektivët e policisë gjetën dhe sekuestruan një sasi lënde narkotike të llojit kokainë, e ndarë në 80 doza të gatshme për t'u shitur në tregun lokal.

Nga veprimet hetimore dyshohet se dy të arrestuarit e siguronin lëndën narkotike, e ndanin atë në doza dhe më pas përdornin automjetin për shpërndarjen e saj në pika të ndryshme të qytetit të Laçit.

Në cilësinë e provës materiale, strukturat e policisë sekuestruan 80 dozat e kokainës, automjetin e përdorur për transportin e lëndës narkotike, si dhe 4 aparate celulare që do t'i nënshtrohen ekzaminimeve për zbardhjen e rrjetit të kontakteve. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për veprime të mëtejshme.

## Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 19 Shtator13:27

### [Aksident në aksin Fier-Patos/ Shpërndarësi i picave përplaset me automjetin, plagoset në këmbë]

Një aksident rrugor është regjistruar paraditen e sotme në aksin Fier–Patos, pikërisht në afërsi të kryqëzi...

AKTUALITET 19 Shtator13:13

### [Vrau me thikë bashkëshorten, vihet në pranga 68-vjeçari]

Hysni Patushi, i cili mëngjesin e të shtunës vrau me thikë gruan e tij, Lumturi Patushi, është arrestuar nga Policia pak orë ...

AKTUALITET 19 Shtator12:25

**Burri vrau me thikë bashkëshorten, krimi në sy të nipit të mitur dhe dhëndrit të tyre**

Zbardhen të tjera detaje në lidhje me ngjarjen e rëndë që tronditi sot Tiranën, ku në rrethana të paqarta burri ka vra...

AKTUALITET 19 Shtator12:12

**E rëndë në Tiranë! Burri vret me thikë bashkëshorten, ngjarja ndodhi në afërsi të SPAK-ut**

Një ngjarje e rëndë është raportuar pak minuta më parë në Tiranë, në afërsi të SPAK-ut, ku një...

AKTUALITET 19 Shtator12:10

**Protestë në Vlorë kundër ndërtimit të muzeut hebraik**

Me flamuj kuq e zi, me kapele të UÇK, me pankarta në duar, një grup i shoqërisë civile në Vlorë po protestojnë ...

AKTUALITET 19 Shtator12:04

**Jep dorëheqjen drejtori i Muzeut të Gjirokastrës pas skandalit me portretin e Çerçiz Topullit**

Kreu i Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore, Florian Hysi, ka dhënë dorëheqjen nga detyra, pas reagimeve të shkaktuara ng...

AKTUALITET 19 Shtator12:02

**Plagosja në Tiranë, reagon policia: U qëllua në ajër pas një konflikti çasti, autori në kërkim**

Një 45-vjeçar është shpallur në kërkim nga Policia e Tiranës, pasi dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri në...

AKTUALITET 19 Shtator11:55

**Caktohet data/ Ja kur do të bëhet pritja diplomatike e ambasadorit të ri të SHBA, Eric Wendt**

Ambasada e SHBA në Tiranë ka shpërndarë ftesa për pritjen diplomatike të Ambasadorit Eric Wendt me datë 2 tetor. Gjeneral-...

AKTUALITET 19 Shtator11:44

**Të shtëna me armë në një kantier ndërtimi në Tiranë, një person i plagosur**

Të shtëna me armë zjarri janë regjistruar në orët e para të mëngjesit në një kantier ndërtimi në T...

AKTUALITET 19 Shtator11:06

**Von der Leyen viziton Shqipërinë, Kosovën, Malin e Zi e Maqedoninë e Veriut, lë jashtë Serbinë dhe Bosnjën**

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, nuk do të vizitojë Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën gjatë turit të ...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 18 Shtator

**VIDEO dramatike/ Të dashurës i erdhi burri, i r...**

Ky është momenti kur një burrë, gjysmë i zhveshur, u rrëzua nga një dritare teksa tentonte të arratisej, pasi dyshohet s...

AKTUALITET 18 Shtator

**Kush është 42-vjeçarja nga Durrësi që u përplas...**

Një ngjarje tragjike ka ndodhur mëngjesin e së premtes në San Donà di Piave, pranë Venecias, ku një 42-vjeçare shqip...

BOTA 18 Shtator

**“Nënë, vazhdo normalisht”/ Banda zhvat 1 milion...**

Një mashtrim i mirëorganizuar duke përdorur inteligjencën artificiale, përmes të cilit anëtarët e grupit kriminal klonon...

INVESTIGIME 19 Shtator14:14

**Pesë muaj pa të birin/ Nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës**

Në shumë raste, ndarja e një çifti me fëmijë të mitur shoqërohet me konflikte, përplasje e drama që godasi...

## video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**




**“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit**




**Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet**





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.